

Thirrje e hapur për propozime projektesh mbi vlerësimet e rrezikut të klimës për çdo Rajon Evropian (Climate Risk Assessments For Every European Region) (CLIMAAX)

Synimi i thirrjes është të mbështesë bashkitë dhe komunitetet në Evropë për të kuptuar, përgatitur dhe menaxhuar më mirë rreziqet klimatike. Thirrja do të financojë autoritetet/komunitetet rajonale/lokale që të zbatojnë strategjitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të rrezikut.

Kush mund të aplikojë:

- Organet publike (përfshirë autoritetet rajonale dhe lokale, bashkitë, si dhe agjencitë publike)
- Organizatat jofitimprurëse që përfaqësojnë një komunitet lokal/rajonale

Përfitimet për përfituesit e zgjedhur:

- Financim deri në 300,000 euro për projektet e zgjedhura
- Akses në Toolbox-in e vlerësimit të rreziqeve të shumëfishta
- Udhëzime metodologjike
- Këshilla dhe mbështetje teknike
- Pjesëmarrje në evente për ndarjen e njohurive

Ditët Informative:

Dy sesione informative: 9 korrik dhe 10 shtator në orën 14:00

Kohëzgjatja e projekteve: Deri në 22 muaj

Afati i fundit për aplikim: 15 tetor 2024, ora 17:00

Linku i thirrjes: <https://getonepass.eu/opportunities/climaax>